



Planuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	21.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	8282/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.977/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani-dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.977/2022 të datës 07.11.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi:

[redacted] kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike "Masa disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.977/2022 e datës 07.11.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Shfuqizohet Masa disiplinore "Vërejte" e shqiptuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës përmes e-mailit të datës 06.10.2022.
- III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, me qëllim të deklarimit të shuarjes dhe largimit të masës disiplinore nga dosja e ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Inspektoratin e Punës, me datë 05.11.2022 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është regjistruar me datë 07.11.2022 me shenjen A.nr.977/2022 dhe numër protokolli 6749/2022, kundër masës disiplinore "vërejte" të shqiptuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës përmes e-mailit të datës 06.10.2022.

Ankuesi më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill pretendon se i njëjti nuk ka mundur të përgatit raport mjekësor pasi që ka shkuar në pushim mjekësor nga data 29 shtator, ndërsa data 30 shtator ka qenë ditë punë dhe nuk ka mundur të dërgohet raporti pa përfunduar komplet muaji, po ashtu inspektorët e punës kanë afat që të raportojnë deri me datën 5 të muajit vijues, po ashtu ankuesi e kishte caktuar zëvendësuesin e tij me rastin e hapjes së pushimit mjekësor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 14.11.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te Inspektorati i Punës, ndërsa me datë 23.11.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me shenjen A.nr.977/2022 me numër të protokollit 6749/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 07.11.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e ankuesit të datës 05.11.2022 dërguar në Këshill nga ankuesi; E-mailin e ankuesit të datës 29.09.2022 dërguar për [redacted] E-mailin e datës 29.09.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin dhe të tjerët; E-mailin e ankuesit të datës 03.10.2022 dërguar nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 03.10.2022 dërguar nga [redacted] për ankuesin; E-mailin e datës 06.10.2022 me masën e shqiptuar disiplinore nga [redacted] E-mailin e datës 06.10.2022 dërguara nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 24.10.2022 dërguar nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 24.10.2022 dërguar nga ankuesi për [redacted] Raporti Mjekësor i datës 21.10.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.11.2022; Përgjigja në kërkesë e datës 23.11.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 06.06.2022; E-mailin e datës 21.11.2022 dërguar nga [redacted] për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës i datës 24.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 06.06.2019 ka konstatuar se ankuesi [redacted] mban pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal në Mitrovicë", në kuadër të Inspektoratit të Punës, ndërsa të njëjtit Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, përmes e-mailit të datës 06.10.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje" me arsyetimin se, citoj: "Në raportimin mujor përmbledhës për muajin shtator që sot pranova, sipas procedurës, nga Departamenti për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore, mungon raportimi i DKR-Mitrovicë", nga lenë të kuptoj se arsyetimi i shqiptimit të kësaj mase është bërë për shkak të mungesës së raportimit në baza mujore nga ankuesi.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe administrimit të shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës nuk ka pasur të drejtë ligjore t'i shqiptoj masën disiplinore ankuesit ngase i njëjti nuk ka autorizim ligjor siç përcaktohet në nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj"*, pasi që Këshilli përmes Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 përmes të cilit e kishte aprovuar Raportit të Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe kishte konstatuar se Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës ishte emëruar në mënyrë të kundërligjshme nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit Nr.01/79 të datës 25.05.2022, respektivisht me rastin e emërimit të të njëjtit ishte vepruar në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që nuk ishte zhvilluar procedurë e rregullt e rekrutimit siç përcaktohet me dispozitat e ligjit material, rrjedhimisht Vendimi i Këshillit me numër Nr.50/2022 të datës 14.07.2022 është bërë i ekzekutueshëm, ngase Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktvendimit 1892/2022 të datës 22.08.2022 e kishte refuzuar kërkesën e palës paditëse, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për aprovimin e masës së sigurisë apo shtyrjes së ekzekutimit të Vendimit të Këshillit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se edhe sikur të mos ekziston të metat ligjore ndërlidhur me kompetencën ligjore që Kryeinspektori i Inspektoratit t'i shqiptoj ankuesit masën disiplinore, Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka konstatuar se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit janë shkelur edhe dispozitat e ligjit material, ngase ankuesi përmes e-mailit të datës 29.09.2022 e kishte njoftuar Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës se me rekomandim të mjekut të njëjtit i është dhënë pushim mjekësor prej 15 ditësh, dhe po ashtu ankuesi në e-mailin e lartcekur e kë vë në dijeni udhëheqësin e drejtpërdrejt se në cilësi të zëvendësuesit të tij më pëlqimin e saj e ka lënë zyrtaren e cila mban pozitën e Inspektorese së Punës, ndërsa bazuar në raportin e lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare në Mitrovicë, andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi ka qenë në pushim mjekësor nga data 30.10.2022 deri me datë 21.10.2022, nga rrjedh se ankuesi e ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore që buron nga marrëdhënia e punës dhe që për bazë ka nenin 18 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe nenin 12 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullore Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: *"1. Zyrtari publik në rast të sëmundjes ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës; 2. Zyrtari publik i cili e shfrytëzon pushimin mjekësor, duhet të informoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe të ofrojë dëshminë përkatëse nga organi kompetent mjekësor"*, sikurse konstatohet fakti se ankuesi e ka njoftuar mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë dhe se mungesën e tij në punë e ka arsyetuar me shenjat e organit mjekësor kompetent, duke përmbushur kështu kriterin e përcaktuar ligjor si në rregulloren e lartcekur.

Me qëllim të shqyrtimit të shqyrtimet ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 7 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"* dhe ka ardhur në përfundimin se Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *"vërejte"* ndaj ankuesit, ka shkelur parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publik të përcaktuara me ligjin material, ngase një nëpunësi civil i cilit gjendet në pushim mjekësor të dëshmuar me shkresat e organit kompetentë, nuk mund t'i kërkohet llogari apo raport pune, deri në momentin që të njëjtit i përfundon pushimi mjekësor, sikurse Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës nuk e ka marr parasysh faktin se ankuesi me datë 29.09.2022 e ka njoftuar të njëjtin se me rastin e hapjes së pushimit mjekësor në cilësi të zëvendësuesit e ka lënë znj. _____ njëherit e njëjta kishte qenë e përfshirë në korrespondencën e e-mailit njoftues të datës 29.09.2022.

Po ashtu, duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 44 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"1. Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike"* dhe në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 i të njëjtit ligj konstatohet fakti se masa e shqiptuar disiplinore *"vërejtje"* nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ siç janë pjesa hyrëse, pjesa urdhëruese, pjesa arsyetuese dhe pjesa përmbyllëse, respektivisht akti i kontestuar me këtë ankesë nuk e përmbush as kriterin e përcaktuar me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim"*, ngase është e pamundur të arsyetohet dhe konstatohet fakti se mbi bazën e cilave dispozita ligjore, Kryeinspektori i Inspektorit të Punës i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore përderisa i njëjti gjendej në pushim mjekësor, sikurse në vërejtjen e dhënë pala nuk është udhëzuar tutje në mjete juridike (këshillën juridike).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave të ligjit material dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa masa disiplinore *"Vërejtje"* e shqiptuar përmes e-mailit të datës 06.10.2022 nga Kryeinspektori i Inspektorit të Punës, është vendim i paligjshëm siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. Organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën"*

administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”, dhe si i tillë masa disiplinore “Vërejtje” e shqiptuar përmes e-mailit të datës 06.10.2022 nga Kryeinspektori i Inspektorit të Punës është shfuqizuar, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson fakti se, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, me rastin e pranimit të Vendimit të Këshillit, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/1-114 për Zyrtarët Publik nënin 51 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “Deklarimi i shuarjes bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës.” duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim që masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit të shuhet dhe e njëjta të largohet nga dosja personale e ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetim të këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.977 /2022

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.